



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01– Nr. 16-35161/16
Kaçanik; 28.10.2016

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 30.1 të Ligjit 03/L-048 -Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të nenit 34.5 lidhur me nenin 61 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr. 3588/2008 të datës 25.09.2008, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me 28 Tetor 2016, mori këtë:

V E N D I M PËR RREGULLIMIN E NDARJEVE BUXHETORE TË KOMUNËS PËR VITIN 2016

1. Buxheti i Komunës do të rialokohet brenda programeve/nën programeve buxhetore për projekte kapitale deri në pesë për qind (5%) të një ndarje buxhetore në një ndarje tjetër të asaj organizate buxhetore gjatë vitit fiskal.

2. Rialokimet brenda pikës së 1. të këtij vendimi do të reflektojnë në këto nën programe dhe për këto projekte:

2.1. Buxhet dhe Financa; Projekti “Mjetet për bashkëfinancim të projekteve me donatorët dhe qytetarët” me kod 43975 do të zvogëlohet nga kursimet e arritura shuma prej 1,618.29 euro nga granti qeveritar dhe 5,000 euro nga të hyrat vetanake.

2.1.1.Mjetet nga ky Projekt do të rriten tek projekti “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në zonat urbane dhe rurale” me kod 43974.

2.2.Shërbimet Publike-Infrastruktura rrugore; Projektet “Asfaltimi i rrugës Gërllicë-Prushaj faza e III-të” me kod 43989 në shumë prej 859.65 euro dhe projekti “Asfaltimi i rrugës në lagjen e Burrënikëve të fshatit Runjevë” me kod 43988 në shumë prej 326.60 euro.

2.2.1.Mjetet e kursyera nga këto projekte do të shfrytëzohen për Projektin “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike” me kod 88641 te i njëjti nën program buxhetor.

2.3. Arsimi – Administrata e Arsimit, Projekti “Rregullimi i varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të UÇK-së” me kod ‘44001’ mbetja nga kursimi në shumë prej 141.17 euro nga granti qeveritar.

2.3.1..Mjetet e kursyera do të shfrytëzohen për projektin “Renovimi i objekteve dhe infrastrukturës shkollore me kod të projektit ‘86263’

2.4. Urbanizmi dhe Mbrojtja e Ambientit, Propjekti “Hartimi i Planeve Rregullative” me kod ‘86253’ kursimi prej 4,668.00 euro nga të hyrat vetanake.

2.4.1.Mjetet e kursyera nga ky projekt do të shfrytëzohen për projektin “Ndërtimi i trotuarit prej QPS-së deri te SHF “Emin Duraku” në Kaçanik.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi mbi Rregullimin e Ndarjeve Buxhetore për Vitin 2016, obligohet Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit.

4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës, dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

